



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.44, datë 28.09.2007

**“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PJESSHME (PJESA E KATËRT) TË INVENTARIT
TË PRONAVE TË PALUAJTSHME, TË CILAT JANË NË TERRITORIN NËN
JURIDIKSIONIN E BASHKISË SË TIRANËS”**

Bazuar në Ligjin Nr.8652, dt.31.07.2000, neni 8/a/c "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", Ligjin Nr.8743, dt.22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", Ligjin Nr.8744, dt.22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë vendore", V.K.M. Nr.500, dt.14.08.2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore", pika 10, Udhëzimit Nr.3 dt.18.07.2002 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore", Udhëzimit Nr.15, dt.30.06.2003 "Për mënyrën e paraqitjes nga Njësitë e Qeverisjes Vendore të kërkesave, për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike", pika 1/a, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I

1. Miratimin e Listës së Pjesshme (pjesa e katërt) të Inventarit të Pronave të Paluajtshme Shtetërore, që ndodhen në territorin nën juridiksionin e Bashkisë së Tiranës. Lista e Inventarit fillon me numrin 1 dhe mbaron me numër rendor 32 dhe ka numër total faqesh 9.
2. Paraqitjen e Listës së inventarit të Pronave të Paluajtshme për miratim në Këshillin e Ministrave.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Administrimit të Aseteve (Sektori i Inventarizimit të Pronave të Paluajtshme).
4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes.

SOKOL DERVISHAJ

K R Y E T A R

